

LIGJ
PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PER THEMELIMIN E KOMISIONIT
SHTETEROR PER VENDIMMARRJE NE PROCEDURE ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURE
TE MARREDHENIES SE PUNES NE SHKALLE TE DYTE

Nen
i 1

Ne Ligjin per themelimin e Komisionit Shteteror per Vendimmarrje ne Procedure Administrative dhe Procedure te Marredhenies se Punes ne Shkalle te Dyte ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 51/11), ne nenin 1 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Komisioni Shteteror eshte kompetent per vendimmarrje ndaj ankesave kunder aktvendimeve te marra ne shkalle te pare ne procedure te mbikeqyrjes inspektuese."

Paragrafi (2) dhe (3) behen paragrafe (3) dhe (4).

Ne paragrafin (4) i cili behet paragrafi (5) pas fjaleve: "dhe organe tjera shtetere" shtohen fjalet: "si dhe ndaj ankesave kunder aktvendimeve te marra ne shkalle te pare ne procedure te mbikeqyrjes inspektuese".

Nen
i 2

Ne nenin 2 paragrafi (2) ne fjaline e pare pika zevendesohet me presje dhe shtohen fjalet: "me te cilin udheheq Sekretari i Pergjithshem."

Nen
i 3

Ne nenin 3 paragrafi (1) fjala "gjashte" zevendesohet me fjalen "dhjete".

Nen
i 4

Ne nenin 8 paragrafi (2) fjala "pese" zevendesohet me fjalen "shtate".

Neni 5

Pas nenit 8 shtohet neni i ri 8-a, si vijon:

"Neni 8-a

(1) Komisioni Shteteror mund te kerkoje nga Keshilli Inspektues te leshoje urdherese per mbikeqyrje inspektuese mbi punen e subjektit te caktuar te mbikeqyrjes te drejtori i inspektoratit, respektivisht personi zyrtar udheheqes i sherbimit inspektues, kur kjo nevojitet per percaktimin e teresishem te gjendjes faktike.

(2) Keshilli Inspektues eshte i obliguar qe ta leshoje urdheresen nga paragrafi (1) i ketij neni ne afat prej tri ditesh nga dita e pranimet te kerkeses."

Nen
i 6

Ne nenin 10 paragrafi (1) pas fjaleve: "paragrafi1" shtohen fjalet: "dhe paragrafi 2".

Nen
i 7

Procedurat e filluara ndaj ankesave kunder aktvendimeve te inspektoreve para komisioneve ne organet e administrates shteterore, organet tjera shteterore dhe njesite e veteqeverisjes lokale dhe qytetit te Shkupit deri ne fillimin e zbatimit te ketij ligji, do te perfundohen nga komisionet ne afat prej gjashte muajsh nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Zgjidhja e lendeve te filluara para dites se fillimit me zbatim te ketij ligji per te cilat eshte ngritur kontest administrativ, do te vazhdoje ne perputhje me dispozitat e ketij ligji.

Ligjet me te cilat eshte percaktuar e drejta e ankeses kunder aktvendimeve te inspektoreve para komisioneve ne organet e administrates shteterore, organet tjera shteterore dhe njesite e veteqeverisjes lokale dhe qytetit te Shkupit, do te harmonizohen me dispozitat e ketij ligji deri ne ditën e fillimit te zbatimit te ketij ligji.

Nen
i 8

Ky ligj hyn ne fuqi ditën e tete nga dita e botimit ne "Gazeten Zyrtare te Republikes se Maqedonise", e do te filloje te zbatohet gjashte muaj nga dita e hyrjes ne fuqi.